

VENDIM
Nr. 167, datë 4.11.2019

**MBI MIRATIMIN E DRAFTKONTRATËS PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE/KESH SHA, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN
PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESIT TË
SHËRBIMIT UNIVERSAL/OSHEE SHA, PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE
FUNDORË PËR PERIUdhËN KOHORE 1.1.2019–31.12.2019**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5 dhe 14, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 95/3 prot, datë 30.10.2019, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike në lidhje me miratimin e “Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 68, datë 10.5.2019, ERE-ja ka filluar procedurën për miratimin e draftkontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, OSHEE sh.a. për periudhën 1.3.2019–31.12.2019.

- Gjatë shqyrtimit të kësaj kontrate janë evidentuar disa ndryshime krahasuar me kontratën në fuqi, miratuar me vendimin nr. 132, datë 7.6.2018 dhe e lënë në fuqi me vendimin nr. 16, datë 18.2.2019. Këto ndryshime konsistojnë kryesisht në nenin 2, pika 1, nenin 3, nenin 9, nenin 11, nenin 12 dhe nenin 14.

- Me shkresën me nr. 176/7 prot, datë 5.6.2019, ERE-ja u ka dërguar palëve të interesit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kërkesën për opinion në lidhje me ndryshimet e evidentuara në kontratën në fuqi, miratuar me vendimin nr. 132, datë 7.6.2018 dhe lënë në fuqi me vendimin nr. 16, datë 18.2.2019, të bordit të ERE-s. Në këtë shkresë ERE-ja ka bërë me dije ndryshimet në draftkontratën të paraqitur nga shoqëria KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a..

- Në vijim me shkresën nr. 176/8 prot, datë 5.6.2019, ERE-ja i është drejtuar shoqërive KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. duke i kërkuar informacion lidhur me dispozitat e ndryshuara, kryesisht në nenin 2, pika 1, nenin 3, nenin 9, nenin 11, nenin 12 dhe nenin 14, si dhe përputhshmërinë e dispozitave të nenit 9, pika 1.1, të kësaj kontrate.

- Gjithashtu ERE-ja i ka kërkuar KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. të bëjnë me dije vendimin e Asamblesë së Shoqërisë, ku, në përputhje me parashikimin e VKM-së nr. 244/2016, është vlerësuar mënyra e përdorimit të të ardhurave shtesë mbi ato të parashikuara në programin ekonomik, siç është parashikuar në nenin 9.1.1 të draftkontratës.

- Me shkresën me nr. 176/13 prot, datë 3.7.2019, ERE-ja i është drejtuar përsëri Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me dakordësinë/miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose

pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, OSHEE sh.a për periudhën 1.3.2019–31.12.2019.

- ERE, me qëllim vijimin e miratimit të kësaj kontrate, zhvilloi një seancë dëgjimore në datën 11.7.2019, mes përfaqësuesve të Entit Rregullator të Energjisë, Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare sh.a., Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financës dhe Autoritetit të Konkurrencës për të diskutuar në lidhje me qëndrimin dhe komentet e palëve mbi dispozitat e kësaj kontrate që lidhen kryesisht me: Përdorimin e të ardhurave shtesë për fondin rezervë, në respektim të parashikimeve të VKM-së nr. 244/2016, neni 5.1 të saj; kuptimin e drejtë nga palët të dispozitave të VKM-së nr. 244/2016, neni 5, pika 3: Parashikimet e vendosura në nenin 9 “Zhdëmtimet/Kompensimet” pika 1, të kontratës.

Qëndrimi i palëve.

- KESH sh.a. sqaron se: Palët kanë vendosur që kompensimi të bëhet në fund të vitit, vetëm nga të ardhurat që shoqëria e prodhimit do të mund të krijojë përgjatë vitit ushtrimor të cilat do të depozitohen në një llogari qëllimore (*Escrow account*), e cila në vetvete përfaqëson një mekanizëm për përmbushjen e këtij detyrimi nga ana e KESH sh.a. sipas kontratës. KESH do të krijojë një fond rezervë për qëllime kompensimi dhe llogaria *Escrow* do të lidhet drejtpërdrejtë me detyrimin për kompensim që ka ndaj palës OSHEE sh.a. Ky fond që do të krijohet, do të përbëjë të ardhura shtesë vetëm në momentin kur viti do të ketë mbaruar dhe rakordimet për sasisë e kontraktuara dhe të nominura do të jenë mbyllur midis palëve dhe do të jenë sqaruar detyrimet që pala KESH sh.a. do të ketë ndaj palës OSHEE sh.a.

- Autoriteti i Konkurrencës ka shprehur mendimin me shkresën me nr. 312/2 prot, datë 2.7.2019, protokolluar me tonën 342/1 prot, datë 3.7.2019 dhe shprehet që: Kontrata me kushtet e saj për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërive gjeneruese/prodhuese të energjisë elektrike, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

- OSHEE sh.a. u shpreh që kjo kontratë është zgjidhja më praktike. Duke marrë shkas nga mosmarrëveshjet që kanë pasur të dy shoqëritë (OSHEE sh.a./KESH sh.a.) u propozua të krijohet kjo llogari, në të cilën do të depozitohen të gjithë eksportet që KESH sh.a., do të realizojë, (jo për efekt optimizimi).

Konstatimet e ERE-s.

- Në nenin 3, “Përkufizimet dhe Ndërtimi” pika 6, “llogaria *Escrow*” është parashikuar në kontratë se, citojmë: “...Në këtë llogari shitësi do të depozitojë të ardhurat e siguruara nga shitja e energjisë elektrike në treg të parregulluar”.

- Sa i përket këtij neni, duke qenë se palët, dhe kryesisht KESH sh.a. është shprehur se llogaria *Escrow* do të shërbejë si një garanci kontrate për sasinë e mosfurnizuar dhe sipas VKM-së nr. 244/2016, të ndryshuar, në nenin 5.3, pika 3, parashikohet ndër të tjera se, citojmë: “...Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga Shoqëria e Prodhimit të Energjisë Elektrike për sasinë e pasiguruar nga Shoqëria e Prodhimit të Energjisë Elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë” në këtë rast duke qenë se llogaria *Escrow* shërben si garanci kontrate, siç janë shprehur vetë palët, ajo duhet të mbushet vetëm me vlerën në lekë të sasisë së pasiguruar të energjisë elektrike me çmimin e përcaktuar në kontratë.

- Në lidhje me afatet e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate, palët kanë dakordësuar hyrjen në fuqi të kësaj Kontrate në datë 1.3.2019, duke preferuar që periudha 1.1.2019–28.2.2019, të mbetet e rregulluar nga Kontrata e miratuar për vitin 2018 dhe lënë në fuqi me vendimin e bordit të ERE-s nr. 16, datë 18.2.2019.

- Në lidhje me kërkesën e palëve në kontratë për shtrirjen e efekteve juridike të kësaj kontrate, konstatohet se, sasia e parashikuar për këtë kontratë është ajo e miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të KESH sh.a., e cila përfshin një periudhë 12-mujore, përgjatë gjithë vitit 2019. Çmimi i miratuar nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë në kuptim të kontratës së rregulluar mes palëve, afekton rregullimin për blerjen e sasisë së energjisë përgjatë vitit 2019.

- Sa i përket sasisë totale të përcaktuar sipas vendimit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 14430/3, datë 19.12.2018, “Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2019 dhe vitet 2019–2023” ajo është përcaktuar në masën 3,950,000 MWh.

- Në nenin 9, “Zhdëmtimet/Kompensimet” pika 1.1, parashikohet në kontratë se, citojmë: “...shitësi pranon të hapë një llogari të dedikuar *Escrow* në monedhën euro në një nga bankat e nivelit të dytë, llogari në të cilën do të depozitohet të gjitha të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike në treg të parregulluar dhe do të shërbejë si garanci për shlyerjen e detyrimeve të shitësit ndaj blerësit. Shitësi merr përsipër të mos i përdorë këto të ardhura për asnjë qëllim tjetër përveçse për qëllimin e përcaktuar në kontratë”.

- Sa i përket këtij neni parashikimi për depozitimin e të gjitha të ardhurave nga shitja në treg të parregulluar, bie ndesh me parashikimin e VKM-së nr. 244/2016, në të cilën nenin 5.1 i saj përcakton se: “Në çdo rast të vendosjes së detyrimit publik ndaj shoqërisë së prodhimit, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti, asambleja e përgjithshme e kësaj shoqërie, pasi merr mendimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, vlerëson rast pas rasti mbi mënyrën e përdorimit të të ardhurave shtesë mbi ato të parashikuara në programin ekonomik...”, duke qenë se shoqëria e prodhimit të vetmet të ardhura që mund të sigurojë mbi ato të kësaj kontrate janë nga shitja në treg të parregulluar, fondi do të humbiste qëllimin për të qenë garanci kontrate, por prezumohet si një fond rezervë për krijimin e të cilit duhet me parë miratimi i MIE-s dhe mendimi i MEF-së, fakt që na është bërë me dije se nuk ekziston, si rrjedhojë parashikimi se shitësi nuk do t’i përdorë këto të ardhura për asnjë qëllim tjetër është jashtë kontekstit të të drejtës së këtij të fundit.

- Neni 9, pika 1.2, parashikon ndër të tjera se, citojmë: “Vlera e kompensimit për blerësin do të jetë për sasinë e paplotësuar pas rakordimit vjetor, por nuk do të jetë me e madhe se vlera e llogarisë *Escrow* nga të ardhurat e siguruar nga shitja në treg të parregulluar.....”.

- Ky parashikim bie ndesh me parashikimin e përmendur dhe më sipër të VKM-së nr. 244/2016, të ndryshuar, në nenin 5.3, pika 3, parashikohet ndër të tjera se, citojmë: “...Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga Shoqëria e Prodhimit të Energjisë Elektrike për sasinë e pasiguruar nga Shoqëria e Prodhimit të Energjisë Elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë” si rrjedhojë vlera maksimale e kompensimit është përcaktuar tashmë nga ana e VKM-së nr. 244/2016 dhe nuk është lënë në dëshirën e palëve.

- I njëjti konstatim vlen dhe për nenin 9, pika 1.3, pjesa, citojmë: “... Nëse vlera maksimale e kompensimit nuk është akumuluar në llogarinë e posaçme, atëherë vlera e kompensimit do të jetë ajo shumë e akumuluar në këtë llogari”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e draftkontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 1.3.2019–31.12.2019” protokolluar në KESH me nr. 1716 prot, datë 5.4.2019 dhe protokolluar në OSHEE me nr. 8020 prot, datë 8.4.2019, me ndryshimet si më poshtë:

a) Emërtimi i Kontratës bëhet: Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019.

b) Neni 2, pika 1, bëhet: Sasia e programuar/kontraktuar e prodhimit të energjisë elektrike që shitësi do t’i lëvrojë blerësit, për vitin 2019, përcaktohet sipas vendimit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 14430/3, datë 19.12.2018, “Mbi miratimin e programit

ekonomiko-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2019 dhe vitet 2019–2023 dhe sipas këtij vendimi është 3,950,000 MWh, sipas tabelës së aneksit 1, bashkëlidhur kësaj kontrate.

c) Neni 3, pika 7, bëhet: Vlera e kompensimit: Vlera që rezulton për sasinë e energjisë së paplotësuar nga shitësi me çmimin e përcaktuar sipas parashikimeve të nenit 5, të VKM-së nr. 244/2016, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.

d) Neni 9, pika 1, bëhet: Rasti i mosperformancës nga ana e shitësit: Në atë shkallë që shitësi (pala livruese) nuk i konfirmon blerësit të gjithë sasinë mujore/javore/ditore të përcaktuar në pikën 1, të nenit 2, të kontratës, por në çdo rast jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e forcës madhore ose nga mosperformanca e palës tjetër, blerësi (pala pranuese) ka të drejtën e një kompensimi për sasinë e energjisë elektrike që rezulton si diferencë ndërmjet sasisë vjetore të përcaktuar në pikën 1, të nenit 2 dhe sasisë vjetore që rezulton si shumë e sasive të konfirmuar/nominuar sipas parashikimeve të nenit 4. Në rast se kjo sasi nuk është plotësuar palët bien dakord që blerësi të kompensohet për këtë sasi sipas parashikimeve të nenit 5, të VKM-së nr. 244/2016, të ndryshuar.

e) Neni 9, pika 1.1, ndryshon: “Me qëllim përmbushjen e këtij detyrimi shitësi pranon të hapë një llogari të dedikuar *Escrow* në monedhën euro në një nga bankat e nivelit të dytë, llogari në të cilën do të depozitohet të ardhurat e nevojshme për garantimin e shlyerjes së detyrimeve për sasi të paplotësuar nga shitësi të detyrimeve kontraktuale sipas parashikimeve të nenit 9, pika 1. Shitësi merr përsipër që këto të ardhura të mos i përdorë për asnjë qëllim tjetër përveçse për qëllimin e përcaktuar në këtë kontratë”.

f) Neni 9, pika 1.2, ndryshon: “Vlera e kompensimit për blerësin do të jetë për sasinë e paplotësuar pas rakordimit vjetor”.

g) Neni 9, pika 1.3, ndryshon: “Pas rakordimeve të sasisë së paplotësuar midis shitësit dhe blerësit dhe nënshkrimit të faturës së kompensimit, blerësi do t’i drejtohet bankës ku është krijuar llogaria *Escrow* me kërkesën për kalimin e vlerës në llogarinë e blerësit sipas nenit 9, pika 1. Në rast se kjo sasi nuk është plotësuar palët bien dakord që blerësi të kompensohet për këtë sasi sipas parashikimeve të nenit 5, të VKM-së nr. 244/2016, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.

h) Neni 11, pika 1 dhe pika 2, bëhen: Kjo kontratë do të hyjë në fuqi në datën e miratimit nga ERE-ja dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2019 deri në datën 31.12.2019. Ajo mund të përfundohet apo ndryshohet vetëm me miratimin e ERE-s. Sasia e kontraktuar sipas pikës 1, të nenit 2, të kësaj kontrate është për të gjithë vitin 2019.

2. KESH sh.a. të informojë OSHEE sh.a. në lidhje me të ardhurat shtesë që ka siguruar gjatë vitit 2019, të destinuara për llogarinë *Escrow* jo më vonë se 10 ditë nga marrja e këtij vendimi.

3. Për periudhën nga data 1.1.2019 deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nëse sasia e energjisë së livruar dhe të marrë, ndryshon nga sasia e energjisë së programuar për livrim, faturimet do të axhustohen nga palët në këtë kontratë për të reflektuar ndryshimet e devijimet midis programit dhe sasisë aktuale të livruar brenda muajit nëntor 2019.

4. Në çdo rast sasia dhe çmimi i shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, nga shoqëria e prodhimit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, është sipas VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.

5. Ky vendim e shtrin fuqinë juridike nga data 1.1.2019 deri në datën 31.12.2019.

6. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Nr. 716/ Prot. Dt. 08/09/2019

Nr. 820/ Prot. Dt. 08/09/2019

Drejtuar: **Z. Petrit Ahmeti**
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë Elektrike
Bulevardi "Bajram Curri", Rr: Viktor Eftimiu, Nr.1023, Tiranë.

Lënda: **Dërgohet kontrata për shit-blerjen e energjisë elektrike.**

I nderuar Z. Ahmeti,

Në respektim të përcaktimeve të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", lutemi miratimin tuaj për kontratën e shit-blerjes së energjisë elektrike nënshkruar midis palëve Shoqëria KESH Sh.A dhe Shoqëria OSHEE Sh.A, për periudhën kohore 01.03.2019-31.12.2019.

Me konsideratë,

Në emër dhe për llogari të KESH Sh.A

Në emër dhe për llogari të OSHEE Sh.A.

Benet BECI

Adrian ÇELA

Administrator i KESH sh.a.

Administrator i OSHEE sh.a.



**KONTRATË PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDERMJET SHOQËRISË SË
PRODIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SH.A, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN
PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR
FURNIZIMIN E KLIENTË VE FUNDORË PËR PERIUDHËN KOHORE
01.03.2019- 31.12.2019**

E lidhur sot me date __. __. 2019, ndermjet:

Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a., regjistruar si person juridik me vendimin Nr.12728, date 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Rr. "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i J61817005F, e përfaqësuar nga Z. Benet BECI, Administrator i Shoqërisë KESH sh.a., që më poshtë do të quhet "Shitësi",

Dhe

Furnizuesi i Shërbimit Universal, me ofertë private, me objekt aktiviteti në: furnizimin me energji elektrike të klienteve fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ofrimin dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit, si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprures me interes për shoqërinë, regjistruar si person juridik me regjistrimin në datë datë 28/03/2018, me seli në Blv. "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88 H.I, Njësia Administrative Nr.7,1023 Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i (L81 530016L), përfaqësuar nga Adrian ÇELA, Administratori i shoqërisë OSHEE sh.a, që më poshtë quhet "Blerësi",

("Palët" ose "Pala" në këtë kontratë do të referohen në cilësinë e Shitësit, prodhuesit aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a) dhe në cilësinë e Blerësit, Furnizuesit të ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal të Furnizimit.

Baza ligjore: neni 20 germa h, e Ligjit Nr. 43/2015, date 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", ndryshuar, Vendimi Nr. 244, datë 30.03.2016, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" i ndryshuar, neni 5 pika 2; Kodi i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, i ndryshuar, Kapitulli II; Vendimi i Bordit të ERE Nr.183, date 10.11.2017 " Mbi miratimin e Kodit të Transmetimit", Vendimi i Bordit të ERE Nr.139/2016 "Mbi miratimin e Rregullave të Përkohëshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike" i ndryshuar, Kapitulli II, pika 2.7; Vendimi i Bordit të ERE Nr. 112, Datë 08.07.2016, "Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal ", Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.97, datë 27.10.2014 "Per licensimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetin e Furnizuesit Publik me Pakicë", Vendimi i Bordit të ERE Nr. 99, datë 17.06.2016, "Mbi miratimin e Licensës së prodhimit të energjisë elektrike " dhe Vendimi i Bordit të ERE nr.98, datë 17.06.2016 "Mbi miratimin e e Licensës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, Vendim i Bordit të ERE Nr.193, datë 24.11.2017 "Mbi miratimin e Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të

energjisë elektrike”, Vendim i Bordit të ERE nr. 264, dt. 20.12.2018 “ Mbi vendosjen e periudhës tranzitore për bërjen efektive të transferimit të licensave të operimit të sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike , të Shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE SH.A) tek shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a (OSSH SH.A); licensës së furnizimit energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të Shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE) sh.a, tek Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a (FSHU sh.a),Vendimi i Ministrit të Infrastruktura dhe Energjisë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të KESH sh.a në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë) nr.14430/3 datë 19.12.2018 “Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë KESH sh.a për vitin 2019”.

Në kushtet kur:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal, në aktivitetin e licencuar të furnizuesit është ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal të Furnizimit me energji elektrike për kategorinë e klientëve fundorë që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit me energji elektrike, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe Vendimit nr.449, datë 15.06.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike ;
- Furnizuesit të Shërbimit Universal i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;
- Sasia e energjisë elektrike, për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, duke u bazuar në nivelin historik mesatar vjetor të dhjetë viteve të fundit, sipas informacionit të dhënë nga ERE dhe regjimit racional të shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese.
- KESH sh.a është shoqëria e prodhimit aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;
- Ministri i Infrastruktura dhe Energjisë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të KESH sh.a në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë) me vendimin nr.14430/3 datë 19.12.2018“Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë KESH sh.a për vitin 2019” ka miratuar sasinë dhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal në kuadër të detyrimit për shërbim publik.
- Sasia e energjisë elektrike dhe çmimi i miratuar pasqyrohen në kontratën e miratuar nga ERE sipas përcaktimeve të shkronjës "h", të nenit 20, të ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike";

Palet bien dakort lidhur me përmbajtjen e kontratës së shit-blejes së energjisë elektrike në kuadër të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik si me poshte vijon:

NENI 1

QËLLIMI I KONTRATËS

Kjo Kontratë (së bashku me Shtojcat e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien e shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet Palëve përfshirë këtu dhe jo vetëm programimin, nominimin, livrimin dhe pranimin e energjisë elektrike për periudhën kohore 01.03.2019- 31.12.2019.

NENI 2

SASIA E KONTRAKTUAR

1. Sasia e programuar/kontraktuar e prodhimit të energjisë elektrike që Shitësi do t'i lëvrojë Blerësit, përcaktohet sipas Vendimit të Ministrit të Infrastruktura dhe Energjisë Nr. 14430/3, datë 19.12.2018 “Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a për vitin 2019 dhe vitet 2019-2023” dhe sipas këtij vendimi është 3,950,000 MWh e cila specifikohet sipas muajve të livrimit sipas tabelës të aneksit 1, bashkëlidhur kësaj kontrate.

OSHEE sh.a. | Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndertesa Nr.88 H.I., Fq: 2 / 15
Njësia Administrative Nr.7,1023 Tirane, Shqipëri
E-Mail: <http://www.oshee.al>

KESH sh.a. | Rr. "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë
Tel +355 4 2241981 | Fax. +355 4 2232046
E-Mail: mail@kesh.al | <http://www.kesh.al>

2. Shitësi në varësi të përmirësimit të kushteve hidrike, të gjithë sasinë e prodhimit të energjisë elektrike mbi atë të parashikuar në pikën 1, por në cdo rast jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit, është i detyruar t'ja ofrojë Blerësit me çmimin e përcaktuar në këtë Kontratë.
3. Blerësi, brenda afateve të përcaktuara nga Shitësi, është i detyruar të konfirmojë mbi mundësinë që ka për të pranuar energjinë e ofruar nga Shitësi sipas parashikimeve në pikën 2. Në rast se Blerësi, brenda afateve të përcaktuara nga Shitësi, nuk konfirmon mbi mundësinë që ka për të pranuar energjinë e ofruar nga Shitësi sipas pikës 2, oferta quhet e refuzuar.

NENI 3

PËRKUFIZIMET DHE NDËRTIMI

1. **Përkufizimet:** Termat e përdorur në Kontratë do të kenë kuptimet e dhëna në Shtojcën 1.
2. **Interpretimi:** Titujt dhe nëntitujt janë vetëm për lehtësi dhe nuk prekin interpretimin e Kontratës.
3. **Referencat në Kohë:** Referencat në kohë do të jenë sipas Kohës Qendrore Evropiane (CET).
4. **Perputhja me Aktet nenligjore dhe Rregullat e Tregut:** Kjo Kontratë hartohet në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore në sektorin e energjisë elektrike. Në rast se ndonjë parashikim në këtë Kontratë bie në kundërshtim me ndonjë parashikim në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, atëherë, ky parashikim në kontratë konsiderohet i pavlefshëm/pazbatueshëm dhe marrëdhënia rregullohet sipas parashikimeve të aktit në fuqi.
5. **Procedurë optimizimi financiar:** Shitja-blerja e energjisë elektrike gjatë vitit kalendarik ku në fund të vitit bilanci financiar rezulton pozitiv.
6. **Llogari escrow:** është hapja nga shitësi e një llogarie në monedhën Euro pranë një Banke të nivelit të dytë, e cila shërben si llogari garancie për kompesimin ndaj blerësit në lidhje me sasitë e paplotësura nga shitësi. Në këtë llogari shitësi do të depozitojë të ardhurat e siguruar nga shitja e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
7. **Vlera e kompesimit:** Vlera që rezulton për sasinë e energjisë së paplotësuar nga shitësi me çmimin mesatar të shitjes së energjisë po nga ana e shitësit në tregun e parregulluar.
8. **Fatura e kompesimit:** Fatura që do të nënshkruhet nga shitësi dhe blerësi në lidhje me sasitë e energjisë të paplotësura nga ana e shitësit.

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERËSIT

1. Blerësi do t'i paraqesë shitësit programet mujore/javore/ditës në avancë me bazë orare/ngarkesës për klientët fundorë në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe sipas formatit të parashikuar në lidhjet e kësaj kontrate.
2. Blerësi jo më vonë se 7 ditë kalendrike përpara fillimit të muajit të livrimit do t'i dërgojë Shitësit gjithë të dhënat që lidhen me parashikimin e ngarkesës për muajin pasardhës me bazë javore/ditore të ngarkesës.
3. Blerësi jo më vonë se dita e merkurë e cdo jave do t'i dërgojë Shitësit të dhënat që lidhen me ngarkesën e klienteve fundorë për sasinë e javës në avancë me bazë ditore/orare.
4. Blerësi duke marrë në konsideratë programet e dërguara për muajin/javën në avancë nga Shitësi, do t'i dërgojë shitësit brenda orës 11:00 programin e ditës në avancë me bazë orare të ngarkesës.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT

1. Shitësi do të livrojë dhe blerësi do të pranojë sasinë e energjisë elektrike të konfirmuar nga shitësi për blerësin sipas parashikimeve në pikën 2, 3 dhe 4, ose sasitë e rena dakort me shkrim midis Shitësit dhe Blerësit. Në rast se nuk do të ketë dakortësi midis palëve, atëherë do të jetë programi i konfirmuar nga shitësi ai që do të prevalojë.
2. Shitësi, jo më vonë se 5 ditë kalendrike përpara fillimit të muajit në të cilin do të bëhet livrimi, do të konfirmojë për blerësin programet mujore/javore/ditore me bazë orare të prodhimit.

OSHEE sh.a. | Bulevardin "Gjergj Fishta", Ndertesa Nr.88 H.I, Fq: 3 / 15
Njësia Administrative Nr.7, 1023 Tirane, Shqipëri
E-Mail: <http://www.oshee.al>

KESH sh.a. | Rr. "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë
Tel +355 4 2241981 | Fax. +355 4 2232046
E-Mail: mail@kesh.al | <http://www.kesh.al>

3. Shitësi në vijim të konfirmimit sipas pikës 2, jo më vonë se dita e enjte e çdo jave, do të konfirmojë për Blerësin programet javore/ditore me bazë orare të prodhimit.
4. Shitësi, duke marrë në konsideratë konfirmimet e dërguara për muajin/javën në avancë do ti dërgojë blerësit brenda orës 12:00 konfirmimin për programin e ditës në avancë me bazë orare të prodhimit dhe do të jetë përgjegjës për realizimin e programit për Ditën në Avancë.

NENI 6

DETYRIMET KRYESORE PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE

1. **Përgjegjësia për balancimin e energjisë:** Shitësi dhe blerësi janë subjekte të rregullave të në fuqi për mekanizimin e balancimit dhe për rrjedhojë përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.
2. **Livrimi dhe Pranimi:** Shitësi do të Programojë, shesë dhe livroje, ose do të beje te mundur te livrohet, dhe Blerësi do të Programojë, blejë dhe pranojë, ose do të beje te mundur te pranohet Sasia e Kontratës sipas programit te deklaruar per dite ne avance; dhe Blerësi do t'i paguajë Shitësit Çmimin përkatës të Kontratës.
3. **Përkufizimi i Programit: "Program"** sipas zbatimit, do të thotë veprimet e nevojshme për një Palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit ose pranimi, që mund të përfshijnë nominimin, programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, a gjentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar perkates, dhe me OST, kur aplikohet, Sasinë e Kontratës, Kapacitetin e Kontratës, Pikën e Livrimit, Programin e Livrimit, Periudhën Totale të Furnizimit, dhe çdo kusht tjetër përkatës të Kontratës sipas gji thë rregullave të zbatueshme të OST -së dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.

NENI 7

LIVRIMI, MATJA, TRANSMETIMI DHE RISKU

1. **Rryma/Frekuenca/Tensionet:** Energjia Elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në Pikën përkatëse të Livrimit sipas standardeve të OST -së dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, kur aplikohet si dhe në përputhje me Rregullat dhe Kodet ne fuqi.
2. **Programet e Deklaruara:** Sasia e Energjise Elektrike qe do të programohet dhe konfirmohet nga Shitësi për Blerësin, do t'i livrohet këtij të fundit mbi baza vjetore, mujore, javore, ditore dhe orare ne perputhje me Rregullat e Tregut te Energjise Elektrike si dhe Kodet e Rrjetit. Nominimi fizik/programi per dite e neserme duhet paraqitur ne oraret ne perputhje me Rregullat te Tregut dhe Kodet ne fuqi.
3. **Dokumentacioni i Livrimeve dhe Marrjeve në Dorëzim:** Bazuar në një kërkesë të arsyeshme, Palët: - do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë ose do të kontrollojë paraqitjen e Programeve, sasive, livrimeve dhe marrjeve në dorëzim të energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi mes afateve të Kontratës Individuale dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike;
4. **Rimbursimi i Kostove të Jashtme:** Në rast se njëra Palë, me kërkesën e Palës tjetër ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga Pala tjetër, pëson shpenzime të jashtme të arsyeshme, kur verifikon se Pala tjetër nuk i ka kryer si duhet detyrimet e saj sipas kushteve të Kontratës, këto shpenzime do të rimburohen me kërkesën e Palës që ka dështuar në performim.
5. **Risqet e Shitësit dhe Blerësit:** Shitësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, transmetimit dhe livrimit të Sasisë së Kontratës deri në Pikën e Livrimit. Blerësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, pranimi dhe transmetimit të Sasisë së Kontratës në dhe nga Pika e Livrimit.
6. **Pikat e Livrimit:** Shitësi do ta livroje energjinë elektrike në hyrje te sistemi t te transmetimit te OST, me kusht që të ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.

NENI 8
MOS-PERFORMANCA PËR SHKAK TË FORCËS MADHORE

1. **Përkufizimi i Forcës Madhore:** Përveç se kur specifikohet ndryshe, "**Forcë Madhore**" për qëllimet e Kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon Forcën Madhore ("**Pala Pretenduese**"), siç përcaktohet në Ligjin nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimin, për shkak të mëposhtme, por pa u kufizuar me to:
 - a) defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterikë të OST -së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimin; ose
 - b) pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimin ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me Programimin sipas Kontratës.
2. **Çlirimi nga Detyrimet e Livrimit dhe Pranimin:** Nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të Forcës Madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas një ose më shumë Kontratave dhe kjo Palë respekton kërkesat e pikes **8.3 (Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore)**, do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo Forcë Madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas pikes **8 (Zhdëmtimet për Paaftësinë për Livrim dhe Pranim)** nuk do t'i merret Palës Pretenduese lidhur me sasi të palivruara ose të pamarra.
3. **Njoftimi dhe Lehtësimi i Forcës Madhore:** Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për Forcën Madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e Forcës Madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t'i sigurojë një vlerësim jo-detyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për të lehtësuar efektet e Forcës Madhore dhe gjatë vazhdimin të Forcës Madhore, do t'i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.
4. **Efektet e Forcës Madhore mbi Palën Tjetër:** Në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të Forcës Madhore, Blerësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të pranimin dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimin për shkak të Forcës Madhore, Shitësi do të çlirohet gjithashtu nga detyrimet korresponduese të livrimit.

NENI 9
ZHDËMTIMET /KOMPENSIMET

1. **RASTI I MOS-PERFORMANCËS NGA ANA E SHITËSIT:** Në atë shkallë që Shitësi ("**Pala Livruese**") nuk i konfirmon Blerësit të gjithë sasinë mujore/javore/ditore të përcaktuar në pikën 1, të nenit 2 të Kontratës, por në çdo rast jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e Forcës Madhore ose nga mos-performanca e Palës tjetër, Blerësi ("**Pala Pranuese**") ka të drejtën e një kompensimi për sasinë e energjisë elektrike që rezulton si diferencë ndërmjet sasisë vjetore të përcaktuar në pikën 1 të nenit 2 dhe sasisë vjetore që rezulton si shumë e sasive të konfirmuar/nominuar sipas parashikimeve të nenit 4. Në rast se kjo sasi nuk është plotësuar atëherë në respektim të parashikimit të nenit 5 të VKM – së nr. 244, datë 30.03.2016, i ndryshuar, palët bien dakort që blerësi të kompensohet për këtë sasi me çmimin mesatar të shitjes së energjisë nga ana e shitesit në tregun e parregulluar.

1.1 Me qëllim përmbushjen e këtij detyrimi shitësi pranon të hapë një llogari të dedikuar escrow në monedhën euro në një nga Bankat e nivelit të dytë, llogari në të cilën do të depozitohet të gjitha të

OSHEE sh.a. | Bulevardin "Gjergj Fishta", Ndertesa Nr.88 H.I. | Fq: 6 / 15
Njësia Administrative Nr.7, 1023 Tirane, Shqipëri
e-Mail: <http://www.oshee.al>

KESH sh.a. | Rr. "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë
Tel +355 4 2241981 | Fax. +355 4 2232046
E-Mail: mail@kesh.al | <http://www.kesh.al>

ardhurat e siguruar nga shitja e energjisë elektrike në treg të parregulluar dhe do të shërbejë si garanci për shlyerjen e detyrimeve të shitësit ndaj blerësit. Shitësi merr përsipër që këto të ardhura të mos i përdorë për asnjë qëllim tjetër përveçse për qëllimin e përcaktuar në këtë kontratë.

- 1.2 Vlera e kompesimit për blerësin do të jetë për sasinë e paplotësuar pas rakordimit vjetor, por nuk do të jetë më e madhe se vlera e llogarisë escrow nga të ardhurat e siguruar nga shitja në tregun e parregulluar në periudhën kohore 01.03.2019-31.12.2019.
 - 1.3 Pas rakordimeve të sasisë së paplotësuar midis shitësit dhe blerësit dhe nënshkrimit të faturës së kompesimit, blerësi do ti drejtohet Bankës ku është krijuar llogaria eskrow me kërkesën për kalimin e vlerës në logarinë e blerësit. Nëse vlera maksimale e kompesimit nuk është akumuluar në llogarinë e posacme, atëherë vlerë e kompesimit do të jetë ajo shumë që është akumuluar në këtë llogari.
 - 1.4 Të ardhurat e krijuara nga procedurat e optimizimit financiar nuk do të jenë objekt i llogarisë escrow.
 - 1.5 Kushtet e krijimit dhe funksionimit të llogarisë escrow do të rregullohen më një marrëveshje të posacme klient dhe Bankë.
 - 1.6 Shitësi cdo muaj do të dërgojë tek blerësi informacion për sasinë e energjisë elektrike të shitur në treg të parregulluar, çmimin me të cilin e ka shitur dhe vlerën e përfutur nga kjo shitje, si dhe vlerën e llogarisë escrow.
2. RASTI I MOSRESPEKTIMIT NGA ANA E BLERËSIT:
- 2.1 Në atë shkallë që programet e dërguara nga Blerësi dhe të konfirmuara nga Shitësi në lidhje me sasinë e energjisë elektrike për muajin përkatës, në përputhje me parashikimet e nenit 4 dhe 5, rezultojnë më të ulëta se sasia e parashikuar në pikën 1 të nenit 2, atëherë shitësi për efekt të llogaritjes së sasisë vjetore të energjisë elektrike në kuadër të detyrimit për shërbim publik, konsiderohet se ka përmbushur detyrimin për periudhën në fjalë në sasinë e përcaktuar në pikën 1 të nenit 2 të kësaj kontrate.
 - 2.2 Në atë shkallë që programet e dërguara nga Blerësi dhe të konfirmuara nga Shitësi në lidhje me sasinë e energjisë elektrike për muajin përkatës, në përputhje me parashikimet e nenit 4 dhe 5, rezultojnë më të larta se sasia e parashikuar në pikën 1 të nenit 2 dhe kjo energji ka shkuar për furnizimin klientëve fundore ose mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, atëherë shitësi konsiderohet se ka përmbushur, në po atë masë shtese, detyrimin për muajin pasardhës që i korrespondon sasisë së parashikuar në pikën 1 të nenit 2 për sasinë që ka shkuar për furnizimin e klientëve fundore, si dhe për rastin kur energjia ka shkuar për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike do ti faturojë blerësit sasinë e energjinë elektrike sipas çmimit të përcaktuar në VKM nr. 244, datë 30.03.2016, i ndryshuar.
3. **Shuma e pagueshme:** shumat e pagueshme sipas nenit 9 do të faturohen dhe paguhen sipas nenit 14 (Faturimi dhe pagesa).

ENI 10 PEZULLIMI I LIVRIMIT

1. Përveç të drejtave ose zhdëmtimeve të tjera të disponueshme për një Palë (" **Pala që përmbush detyrimet**"), nëse njëra Palë (" **Pala që nuk përmbush detyrimet**") nuk paguan ndonjë pagesë të vendosur sipas Kontrates, ose nëse ajo ose Garanti i Kredisë nuk arrin ta sigurojë, zëvendësojë ose rrisë shumën e Sigurisë së Performancës të kërkuar sipas Kontrates ose çdo Dokumenti Mbështetës të Kredisë, Pala që përmbush detyrimet do të autorizohet, jo më parë se tre (3) Ditë Pune pas dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës që nuk përmbush detyrimet, që të pushojë menjëherë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike (dhe të çlirohet (dhe jo thjesht të pezullohet) nga detyrimet kryesore të livrimit) sipas gjithë Kontratave Individuale deri kur Pala që përmbush detyrimet të ketë marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë gjithë interesat e mospagimit dhe shpenzimet e zbatueshme) të gjithë shumave të papagëdara që i detyrohen palës që përmbush detyrimet. Pezullimi i

livrimeve, apo clirimeve te detyrimeve te tjera te livrimit, nga Palet mund te behet vetem me miratimin e ERE.

NENI 11

KOHËZGJATJA DHE TË DREJTAT E PËRFUNDIMIT

1. Kjo Kontrate do të hyjë në fuqi në datën e Miratimit nga ERE dhe i shtrín efektet nga data 01.03.2019 deri më 31.12.2019. Ajo mund të përfundohet apo ndryshohet vetëm me miratimin e ERE-s. Sasi e kontraktuar sipa pikës 1 të nenit 2 të kësaj kontrate është për të gjithë vitin 2019. Marrëdhëniet deri më datë 28.02.2019 do të rregullohen sipas kontratës së miratuar me Vendim të Bordit të ERE Nr.132, date 07.06.2018, afati i së cilës është shtyrë me Vendim të Bordit të ERE Nr. 16, date 18.02.2019.
2. Kjo kontratë mund të përfundohet apo ndryshohet vetëm me miratimin e ERE-s.

NENI 12

ÇMIMI

Çmimet i shitjes së energjisë elektrike kësaj kontrate është ai i përcaktuar me Vendimin Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë KESH sh.a nr. 14430/3, datë 19.12.2018 dhe ky cmim i shitjes do te jete 1.5 leke/kWh.

NENI 13

KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË FINANCIARE

1. **Përfshirja e Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikave 13.2 dhe 13.3 dhe përveç kur lidhet me shumën e pagueshme sipas nenit 9 (**Zhdëmtimet**), një Palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, kontraktorët dhe/ose agjentët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj Palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm ("**Dëmet**"), (përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një Kontrate Individuale) që pëson Pala tjetër sipas Marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto Dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mospagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një Pale ose punonjësve, zyrtarëve, kontraktorëve dhe/ose agjentëve të saj, përdorur nga kjo Palë për kryerjen e detyrimeve të saj sipas Kontrates.
2. **Dëmi Pasues dhe Kufizimi i Përgjegjësisë Financiare:** Subjekt i pikës 13.3, përgjegjësia ligjore e një Pale sipas Kontrates ose lidhur me të:
 - (a) nuk përfshin përgjegjësinë financiare për Dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të paras hikuara; dhe
 - (b) kufizohet me një shumë të barabartë me shumën e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një Palë sipas çdo Kontrate Individuale përkatëse me kusht që ky kufizim të mos zbatohet për pagesat sipas pikës 9 (**Zhdëmtimet për Paafitësinë për Livrim dhe Pranim**).
3. **Mospagesa e Qëllimshme, Mashtrimi dhe të Drejtat Themelore:** Asgjë në Marrëveshje nuk vepron për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë ligjore të Palës për:
 - (a) mospagesën e qëllimshme,
 - (b) mashtrimin; ose
 - (c) çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një Pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një Pale.
4. **Detyra për Lehtësimin e Humbjeve:** Për shmangien e dyshimit, dhe subjekt i Legjislacionit në Fuqi, çdo Palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë Dëmet dhe premtion që do të përdorë përpjekje komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo Dëmi që mund të pësojë sipas Kontrates ose lidhur me të.

NENI 14

FATURIMI DHE PAGESA

1. Fatura; Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasitë totale të Energjisë Elektrike të programuar nga shitësi dhe

blerësi sipas programeve ditore të konfirmuara për Muajin paraardhës. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të Muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës). Krahas faturës, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit edhe të dhënat shoqeruese që lidhen me faturimin. Blerësi brenda datës 20 të muajit pasardhës të pranimit të programit të energjisë elektrike, duhet të dergojë shitesit informacion mbi sasine faktike shitur klinteve fundore, me qëllim sistemimin e veprimeve sipas nenit 9 të kësaj kontrate.

2. Pagesa; Blerësi do t'i kryejë pagesën Shitësit kundrejt vlerës së faturës Mujore. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të faturës tek blerësi. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.
3. Vonesa në kryerjen e pagesës; Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë Kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas legjislacionit në fuqi. Në llogaritjen e kamatëvonesës nuk përfshihet data kur kryhet pagesa
4. Shumat e diskutueshme; Për çdo pretendim që lidhet me saktësinë e faturës, do të jepet një shpjegim me shkrim nga Shitësi ose Blerësi dhe korrektimet në faturë do të bëhen vetëm brenda Muajit të faturuar, në të kundërt do të paguhet shuma e faturuar jo më vonë se data e afatit të pagesës dhe diferencat (shtesat apo pakesimet) nga korrektimet do të reflektohen në Muajit pasardhës.

ENI 15 TVSH-JA DHE TAKSAT

1. TVSH-ja: Të gjitha shumat e referuara në këtë Kontratë përjashtojnë çdo vlerë të zbatueshme të taksës së shtuar ("TVSH"). Nëse TVSH-ja është e pagueshme për çdo shumë të tillë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një shumë të barabartë me TVSH -në me tarifën e zbatueshme. Një shumë e barabartë me TVSH-në e pagueshme nga një Palë do të kërkohej për t'u paguar vetëm kur Pala tjetër të sigurojë një faturë të vlefshme TVSH -je lidhur me atë shumë. Çdo Palë, për aq sa e lejon ligji, do t'i sigurojë palës tjetër fatura TVSH-je shtesë të vlefshme që kërkohej për qëllimet e Kontrates.
2. **Detyrimet e Taksave të Shitësit dhe Blerësit:** Shitësi do të paguajë ose shkaktojë pagesën e gjithë Taksave për Sasinë e Kontratës ose lidhur me të që del para transferimit të riskut dhe titullit në Pikën e Livrimit. Blerësi do të paguajë ose do të shkaktojë pagesën e gjithë Taksave në Sasinë e Kontratës ose lidhur me të ose të Kontratës Individuale që dalin gjatë ose pas transferimit të riskut dhe titullit në Pikën e Livrimit (përveç Taksës direkte ose indirekte që lidhet me shitjen e Sasisë së Kontratës dhe është përgjegjësi ligjore e Shitësit). Në rast se Shitësi i kërkohej me ligj të paguajë çdo Taksë të përshatshme për llogarinë e Blerësit, Blerësi do ta zhdëmtojë ose rimburojë menjëherë Shitësin për këtë Taksë. Në rast se Blerësi i kërkohej me ligj të paguajë çdo Taksë të përshatshme për llogarinë e Shitësit, Blerësi mund ta zbrësë shumën e kësaj Takse nga shumat e detyrueshme Shitësit sipas Kontrates dhe Shitësi do ta zhdëmtojë ose rimburojë menjëherë Blerësin lidhur me këto Taksa të pazbritura. Nëse ndonjë Taksë e re bëhet e zbatueshme ose një Taksë ekzistuese rritet lidhur me Kontratën dhe Blerësi është në gjendje ta kalojë përmes një pale të tretë, Blerësi do të jetë përgjegjës për këtë Taksë të re ose të rritur.
3. Taksa e Mbajtjes: Pagesat Lirë dhe Qartë. Gjithë pagesat sipas një Kontratë Individuale do të bëhen pa mbajtje ose zbritje për llogari të çdo Takse përveç kur kjo mbajtje ose zbritje kërkohej me ligj. Nëse një Palë i kërkohej të mbajë ose zbrësë Taksën nga një pagesë që duhet të bëjë, atëherë ajo Palë ("Pala Paguese") do të njoftojë menjëherë Palën tjetër ("Pala Marrëse") për këtë kërkesë dhe do t'u paguajë autoriteteve të duhura gjithë shumat e mbajtura ose të zbritura prej saj. Nëse mund të lëshohet një faturë ose provë tjetër që evi denton pagesën tek autoritetet, Pala Paguese do t'ia dorëzojë këtë provë (ose njëkopje të certifikuar) Palës Marrëse.
4. **Minimizimi i Taksave:** Të dyja Palët do të përdorin përpjekje të arsyeshme për të administruar Kontraten dhe për të zbatuar dispozitat e saj sipas synimit për minimizimin e akumulimit të detyrimeve për pagesën e Taksës, kur është e arsyeshme dhe e mundur.

NENI 16
SIGURIMI I PASQYRAVE FINANCIARE DHE VLERA NETO E PREKSHME

1. **Sigurimi i pasqyrave financiare:** përveç kur specifikohet ndryshe, nëse kërkohet nga njëra palë.
Pala tjetër do t'i dorëzojë asaj:
 - a) brenda 180 ditëve pas mbarimit të çdo viti fiskal, një kopje të raportit vjetor që përmban pasqyra financiare të audituara dhe të konsoliduara për këtë vit fiskal, për periudhën kur detyrimi i Palës tjetër mbështetet nga garantuesi i kredisë ose nëse është palë e një marrëveshje kontrolli dhe transferimi të fitimit, nga garantuesi i kredisë ose Pala Kontrolluese, sipas rastit; dhe
 - b) brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas përfundimit të secilit nga tre tremujorët e tij fiskalë të çdo viti fiskal, një kopje të raportit tremujor që përmban pasqyra financiare të paaudituar të konsoliduar.
2. **Rënia e vlerës neto të prekshme:** sapo të bëhet e ndërgjegjshme për këtë rënie, çdo Palë do të njoftojë menjëherë Palën tjetër për ndodhinë e rënies të vlerës neto të prekshme ose vlerës neto të prekshme të garantuesit të kredisë ose palës kontrolluese, në një nivel nën shumën e specifikuar nga Palët.
3. **Parimet financiare:** në çdo rast deklaratat financiare që referohen në pikën 17 do të përgatiten sipas parimeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

NENI 17
TRANSFERIMI

1. **Ndalimi:** Asnjëra Palë nuk do të autorizohet që t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontrates, një palë të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme, dhe me miratimin e ERE -s.
2. **Transferimi tek Filialet:** Çdo Palë do të autorizohet t'ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas Kontrates, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, një Filiali me aftësi paguese të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër dhe, me kusht që çdo Dokument Mbështetës Kredie i nxjerë ose i vendosur në emër të Palës transferuese të jetë rinxjerrë ose amenduar fillimisht për të mbështetur detyrimet e Filiait në përfitim të Palës tjetër.

NENI 18
PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

1. Nëse specifikohet si e zbatueshme për Palët, ajo Palë përfaqëson dhe garanton në këtë mënyrë Palën tjetër pas hyrjes në këtë Kontratë për sa vijon:
 - a) se është një Njësi e organizuar si duhet, që ekziston në mënyrë të arsyeshme dhe sipas ligjeve të juridiksionit të korporatës ose organizatës;
 - b) nënshkrimi dhe hyrja në Kontratë, në çdo Dokument Mbështetës Kredie ku është palë dhe në kryerjen e transaksioneve të shqyrtuara këtu, nuk do të shkelin asnjë dispozitë të dokumenteve kushtetuese;
 - c) ka pushtetin dhe është e autorizuar të ekzekutojë, shpërndajë dhe kryejë detyrimet sipas Kontrates dhe çdo Dokumenti Mbështetës të Kredisë ku është palë dhe ka ndërmarrë gjithë veprimet e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin, livrimin, kryerjen dhe hyrjen në Kontratë dhe ekzekutimin, livrimin dhe kryerjen e Kontratës dhe se çdo Dokument Mbështetës Kredie nuk shkel dhe nuk bie në konflikt me asnjë afat ose kusht tjetër të ndonjë kontrate ku është palë ose ndonjë dokument konstitucional, rregull, ligj ose rregullore në fuqi;
 - d) ka gjithë autorizimet qeveritare dhe rregullatore, miratimet dhe pëlqimet e nevojshme për të kryer detyrimet sipas Kontratës dhe çdo Dokumenti Mbështetës të Kredisë ku është palë; (e) ka negociuar, ka hyrë dhe ka ekzekutuar Kontratën dhe çdo Dokument Mbështetës Kredie ku është palë si kryesore (dhe jo si agjent ose me ndonjë kapacitet tjetër, kujdestar apo ndryshe);

- e) hyn rregullisht në marrëveshje për tregtimin e energjisë elektrike siç planifikohet nga Kontrata, dhe e bën këtë mbi baza profesionale sipas linjës së vet kryesore të biznesit, dhe mund të karakterizohet në mënyrë të arsyeshme si palë profesioniste tregu;
- f) vepron për llogari të vet (dhe jo si këshilltar, agjent, agjent ndërmjetës ose me ndonjë kapacitet tjetër, kujdestar apo ndryshe), ka marrë vendimin e vet të pavarur për të hyrë në këtë Kontratë dhe nëse kjo Kontratë është e përshtatshme ose si duhet për të, bazuar në gjykimin e vet, nuk mbështetet mbi këshillën ose rekomandimet e Palës tjetër për ta bërë këtë, dhe është e aftë për të vlerësuar meritat dhe kupton dhe pranon afatet, kushtet dhe risqet e Kontratës;
- g) Pala tjetër nuk vepron si kujdestar apo këshilltar i saj;
- h) nuk mbështetet në asnjë përfaqësim të bërë nga Pala tjetër përveç atyre të thëna shprehimisht në Kontratë ose në Dokumentin Mbështetës të Kredisë ku është palë;
- i) lidhur me një Palë që është Njësi qeveritare ose sistem energjetik publik, kjo Njësi qeveritare ose sistem energjetik publik përfaqëson dhe i garanton Palës tjetër si më poshtë:
- j) gjithë aktet e nevojshme për ekzekutimin e vlefshëm, shpërndarjen dhe kryerjen e Kontratës, përfshirë pa kufizim, ofertat konkurruese, njoftimin publik, zgjedhjen, referendumin, përvetësimin paraprak ose procedura të tjera të kërkuara që janë ndërmarrë ose kryer ose do të ndërmerren dhe kryhen
- k) hyrja në Kontratë dhe zbatimi i saj nga një Njësi qeveritare ose sistem energjetik publik bëhet për një qëllim të duhur publik brenda kuptimit të dokumenteve përkatëse konstitucionale ose qeveritare dhe legjislativi ne fuqi; dhe
- l) afati i Kontratës nuk zgjatet përtej ndonjë kufizimi të zbatueshëm të vendosur nga ndonjë dokument tjetër përkatës konstitucional ose qeveritar dhe nga legjislativi ne fuqi; dhe
- m) lidhur me një Palë, se nuk ka falimentuar, dhe nuk ka procedime ligjore ose administrative pezull ose kërcënuese ku të jetë palë dhe që në dijeni të saj do të ndikojnë materialisht në mënyrë të dëmshme aftësinë e saj për kryerjen e çdo detyrimi sipas kësaj Kontrate ose ndonjë Dokumenti Mbështetës të Kredisë ku është palë, të tilla që ta bëjnë të falimentonte.

NENI 19

PERSONAT E KONTAKTIT

1. Të gjitha njoftimet, që dërgohen sipas ose në lidhje me këtë Kontratë, duhet të dërgohen me shkrim në adresën e mëposhtme me email ose faks:

Për Furnizuesit të Shërbimit Universal	Për KESH
Administratori i Kontratës	
Z/Znj. Etleva Joti (AGOLLI) Funksioni Drejtor Operacional/DTE Adresa Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.I, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane. Mob:+ 355694140008 E-mail: Etleva.agolli@oshee.al	Z/Znj Erideta Bashi Drejtori i Departamentit të Operacioneve Tregtare Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Tel.: + 355 4 2241981/249 Mob:+ 355696052851 Fax: + 355 4 2232046 E-mail: dot@kesh.al ;
Programimi	
Z/Znj Ermira Staka Funksioni: Specialist/Drejtorja e Blerjes se Energjië ne treg te rregulluar/DTE.	Z/Znj Rakela Llanaj Përgjegjëse, Sektori I Administrimit të Transaksioneve

OSHEE sh.a. | Bulevardin "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr.88 H.I., Fq: 10 / 15
Njësia Administrative Nr.7,1023 Tirane, Shqipëri
E-Mail: <http://www.oshee.al>

KESH sh.a. | Rr. "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë
Tel +355 4 2241981 | Fax. +355 4 2232046
E-Mail: mail@kesh.al | <http://www.kesh.al>

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane. Mob:+ 355694147922 E-mail: ermira.staka@oshee.al	Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Tel.: + 355 4 2241981/263 Mob:+ 355694033490 Fax: + 355 E-mail: scheduling@kesh.al
Back Office	
Z. Ceno Klosi Funksioni Drejtor i Departamentit Ekonomik Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane. Mob:+ 355694145377 E-mail: ceno.klosi@oshee.al	Z/Znj Ina Malaj Përgjegjës, Sektori i Administrimit të Kontratave Adresa: Rr."Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë Tel.: + 355 4 2241981/263 Mob:+ 355698025300 Fax: + 355 4 2232046 E-mail: backoffice@kesh.al

NENI 20

LEGJISLACIONI NE FUQI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- Legjislacioni në Fuqi:** Përveç kur specifikohet ndryshe, kjo Kontrate do të interpretohet dhe drejtohet nga legjislacioni në fuqi të RSH.
- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve:** Përveç kur specifikohet ndryshe, çdo mosmarrëveshje që ngrihet lidhur me Kontraten do t'i referohet fillimisht për zgjidhje ERE-s. Secila palë mund të kërkojë gjithashtu zbatimin nga Gjykata të të drejtave të saj kontraktuale.

NENI 21

TË NDRYSHME

- Regjistrimi i Bisedave Telefonike:** Çdo Palë lejohet të regjistrojë bisedat telefonike të mbajtura lidhur me Kontraten dhe t'i përdorë si provë. Çdo Palë heq dorë nga çdo njoftim tjetër mbi këtë regjistrim dhe pranon se ka marrë gjithë pëlqimet e nevojshme të zyrtarëve dhe punonjësve të vet për këto regjistrime.
- Njoftimet dhe Komunikimet:** Përveç kur parashikohet ose vendoset ndryshe nga Palet, gjithë njoftimet, deklaratat ose faturat e dërguara nga një Palë tjetër duhet të jenë me shkrim dhe duhen dorëzuar me letër (postë që arrin brenda 24 orësh ose korrier, postë e parapaguar) ose faksimile. Çdo Palë mund ta ndryshojë informacionin e njoftimit me anë të një njoftimi me shkrim palës tjetër. Njoftimet me shkrim, deklaratat dhe faturat do të konsiderohen si të marra dhe efektive:
 - nëse shpërndahen dorazi Ditën e Punës, ose Ditën e parë të Punës pas datës së l ivrimit nëse shpërndahen jo në Ditën e Punës;
 - nëse dërgohen me postë të klasit të parë, Ditën e 2^{të} të Punës pas datës së postimit, ose nëse dërgohen nga një shtet në tjetrin, në Ditën e 5^{të} të Punës pas datës së postimit;
 - nëse dërgohen me transmetim fa ksimile dhe prodhohet një raport i vlefshëm transmetimi që konfirmon marrjen, ditën e transmetimit nëse është transmetuar para orës 17.00 (me orën e marrësit) në Ditën e Punës ose në orën 09.00 (me orën e marrësit) në Ditën e parë të Punës pas transmetimit.
- Amendimet:** Çdo amendim ose shtesë në këtë Kontrate do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët, dhe hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga ERE.

4. **Pavlefshmëria e Pjesshme:** Nëse, në çdo kohë, ndonjë dispozitë e kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, në çdo drejtim, sipas ligjit të çdo juridiksioni përkatës, ligjshmëria, vlefshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të mbetura të kësaj Kontrate, nuk do të preken ose dëmtohen në ndonjë mënyrë. Palët ndë marrin zëvendësimin e çdo dispozite të paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme me një dispozitë të ligjshme, të vlefshme dhe të zbatueshme që afrohet sa më shumë me dispozitën e pavlefshme lidhur me qëllimin e saj ekonomik, subjekt i aprovimit nga ERE.
5. **Të Drejtat e Palës së Tretë:** Palët nuk presin që ndonjë palë e tretë të ketë të drejta ose të jetë e aftë të zbatojë Kontraten dhe Palët përjashtojnë për aq sa është e lejueshme nga legjislacioni në fuqi, çdo të drejtë të këtyre palëve të treta që mund të nënkuptohet.

NENI 22

MIRATIMI I ERE-S, HYRJIA NE FUQI, EFEKTET DHE ZGJIDHJA E PARAKOHSHME

1. Kjo Kontrate, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga Bordi i ERE dhe i shtrinë efektet për periudhën 01.03.2019 – 31.12.2019.
2. Kjo kontratë mund të ndryshohet apo zgjidhet përpara dates se mbarimit të saj, vetëm me miratimin e ERE.

NENI 23

Kjo kontratë nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.

OSHEE
OPERATORI I SUPERNADARËS
SI ENERGJIJE ELEKTRIKE

Adrian ÇELA
ADMINISTRATOR



kesh
KOMPORATA
ELEKTROENERGJITIKE
SHQIPTARE

Benet BECI
ADMINISTRATOR



Shtojca 1 e Kontrates Termat e Përcaktuara

Termat e përdorur në Kontrate do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Pala Pranuese" ka kuptimin e specifikuar në piken 9.1 (**Paftësia për Livrim**) të kesaj Kontrate;

"Filial" lidhur me një Palë do të thotë një Njësi e Kontrolluar, direkt ose indirekt, nga ajo Palë, çdo Njësi që Kontrollon direkt ose indirekt atë Palë ose çdo Njësi direkt ose indirekt nën Kontrollin e përbashkët të një Pale;

"Kontrate" ka kuptimin e specifikuar në nenin 1 (**Subjekti i Kontrates**);

"Çmimi Referues Alternativ i Mallit" ka kuptimin, nëse ekziston, të specifikuar në çdo Kontratë Individuale që përmban një Çmim të Paqëndrueshëm;

"Dita e Punës" do të thotë një ditë (përveç së shtunës dhe së dielës) në të cilën bankat komerciale janë të hapura për biznes të përgjithshëm në vendet ku secila Palë ka zyrën e saj të regjistruar;

"Blerës" ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale;

"Disbalanca" është diferenca midis fluksit të energjise elektrike të percaktuar nga një kontratë dypalëshe (nominimi fizik i programit për ditën në avance) dhe fluksit aktual të matur të energjise, për një orë të caktuar;

"Përgjegjësia për Balancimin" çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike

"Data e Llogaritjes" ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale të Çmimit të Paqëndrueshëm;

"Metoda e Llogaritjes" ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale të Çmimit të Paqëndrueshëm;

"Koha Qendrore Evropiane" ose **"CET"** do të thotë Koha Qendrore Evropiane dhe do të përfshijë Kohën Dimërore Qendrore Evropiane dhe Kohën Verore Qendrore Evropiane sipas zbatimit;

"Konfirmimi" ka kuptimin e specifikuar në Nenin 4 dhe 5;

"Kapaciteti i Kontratës" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë, kapaciteti i vendosur mes Palëve, i shprehur në MË;

"Çmimi i Kontratës" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë, çmimi i vendosur mes Palëve;

"Sasia e Kontratës" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë, sasia e vendosur mes Palëve, sipas nenit 2 të kesaj kontrate, e shprehur në MË h;

"Kontroll" do të thotë pronësia e më shumë se pesëdhjetë për qind (50%) të fuqisë votuese të një Pale ose Njësie

"Vlerësimi i Kredisë" lidhur me një Njësi do të thotë sa më poshtë: (i) vlerësimi afatgjatë i pasiguar, i pavarur i borxhit publik (i pambështetur nga vlerësimi i kredisë së palës së tretë); (ii) vlerësimi i kredisë të nxjerrësit të borxhit; ose (iii) vlerësimi i kredisë së korporatës që i është dhënë asaj njësie, në secilin rast (i) deri (iii) nga Grupi i Vlerësimit Standard & dhe të Varfër (divizion i McGraë -Hill Inc.) ose Moody's Investor Services Inc.;

"Dokumentet Mbështetës të Kredisë" ka kuptimin e specifikuar, që mund të përfshijë, pa kufizim, një garantues, garanci bankare, letër ndërgjegjësimi, letër kredie ose çdo marrëveshje për mbështetje kredie;

"Garantuesi i Kredisë" ka kuptimin e specifikuar lidhur me një Palë të specifikuar;

"Shtojca Ndërkufitare" ka kuptimin e specifikuar në piken 21(k) (**Përfaqësimet dhe Garancitë**);

"Dëmet" ka kuptimin e specifikuar në piken 12.2 (**Përfshirja e Përgjegjësiave Financiare**)

"Pala që nuk përmbush detyrimet" ka kuptimin e specifikuar në piken 9.1 (**Pezullimi i Livrimit**);

"Pala Livruese" ka kuptimin e specifikuar në piken 9.1 (**Paaftësia Livruese**);

"Pika e Livrimit" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë pika e livrimit e vendosur mes Palëve;

"Programi i Livrimit" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë programi i livrimit i vendosur mes Palëve per ditën në avanse sipas rregullave perkatese;

"Data e Pagesës" ka kuptimin e specifikuar në piken 14.2 (**Pagesa**);

"EBIT" do të thotë fitimet para interesit dhe taksave që, lidhur me vitin përkatës fiskal, do të jenë të ardhurat neto të Njesisë Përkatese para zbritjes së taksave të fitimit (ose çdo takse tjetër mbi të ardhurat ose fitimet në C juridiksionin përkatës të Njesisë Përkatese); plus shumën e gjithë interesave dhe çdo shumë në natyrën e interesit që u ngarkohet shpenzimeve që lidhen me detyrimin financiar për paratë e marra borxh (shuma që përfshijnë borxhet e pagueshme Filialeve si dhe instrumentet e borxheve të institucioneve financiare) të Njesisë Përkatese;

"Kosto reale" ka kuptimin e të gjitha shpenzimeve që identifikohen nga kompania për sigurimin e energjisë elektrike nga burimet perkatese perfs hire edhe gjithë kostot shtese te paparashikuara (overdraft) si dhe çdo vlerësim mbi impaktin e transaksionit në treguesit e e eficenses se perdorimit te rezervave ujore;

"Data e Hyrjes në Fuqi" ka kuptimin e vendosur në faqen e parë të kësaj Kontrate;

"Njësia" do të thotë një individ, qeveri ose shtet ose divizion, agjenci qeveritare ose shtetërore, korporatë, partneritet ose ndonjë njësi tjetër siç mund ta kërkojë konteksti;

"ERE" do të thotë Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, ose çdo organizatë pasuese me autoritet të krahasueshëm mbi tarifën, afatet dhe kushtet e energjisë elektrike;

"Forca Madhore" ka kuptimin e specifikuar në piken 7.1 (**Përcaktimi i Forcës Madhore**);

"Fondet nga Operimi" do të thotë shuma në cash e gjeneruar ose e përdorur nga Njësia Përkatese për aktivitetet e saj operuese;

"Fitimet" ka kuptimin e specifikuar në piken 11.2(b) (**Shuma e Marrëveshjes Financiare**);

"Mbajtës" ka kuptimin e specifikuar në piken 5.1 (**Livrimi dhe Pranimi Sipas një Opsioni**);

"Përqindja e Interesit" ka kuptimin e specifikuar në pikën 4.1 të nenit 13 (**Interesi i Mospagesës**);

"Kontrata Individuale" ka kuptimin e specifikuar në piken 1.1 (**Subjekti i Kontrates**);

"Letra e Kredisë" do të thotë një letër e parevokueshme garancie për kredinë e pagueshme me kërkesë sipas formës dhe përmbajtjes së pëlqyeshme nga Pala Kërkuese dhe që nxirret nga një institucion financiar Tarifa e Kredisë së të cilit është të paktën tarifa e specifikuar nga palet (**Tarifa e Kredisë së Siguruesit Mbështetës të Kredisë që është Bankë**);

"Humbjet" ka kuptimin e specifikuar në piken 11.2(c) (**Shuma e Marrëveshjes Financiare**);

"Ndryshimi i Dëmshëm Material" ka kuptimin e specifikuar në piken 17.2 (**Ndryshimi i Dëmshëm Material**);

"Arsyeja Materiale" ka kuptimin e specifikuar në piken 10.5 (**Përkufizimi i Arsyes Materiale**);

"Pala që permbush detyrimet Jo-Mospaguese" ka kuptimin e specifikuar në piken 9 (**Pezullimi i Livrimit**);

"Përfundimi i Zakonshëm" ka kuptimin e specifikuar në piken 10.2 (**Data e Mbarimit të Afatit dhe Njoftimi 30 Ditor i Përfundimit**);

"OST" do të thotë Operatori i Sistemit të Transmetimit;

"OSHEE" do të thotë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike;

"FSHU" do të thotë Furnizuesi i Shërbimit Universal

"Pala Paguese" ka kuptimin e specifikuar në piken 14.3(a) (Pagesat Lirë dhe Qartë);

"Siguria e Performancës" ka kuptimin e specifikuar në piken 17.1 (Siguria e Performancës);

"Pala Marrëse" ka kuptimin e specifikuar në piken 14.3(a) (Pagesat Lirë dhe Qartë);

"Njësia Përkatese" ka kuptimin e specifikuar në piken 17.2 (a) (Vlerësimi i Kredisë); "Pala Kërkuese" ka kuptimin e specifikuar në piken 17.1 (Vlerësimi i Kredisë);

"Programi" ka kuptimin e specifikuar në piken 4.2 dhe 5.2 (Përkufizimi i Programit) dhe "I Programuar" dhe

"Programimi" do të interpretohen sipas kësaj;

"Shitës" ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale;

"Shuma e Marrëveshjes Financiare" ka kuptimin e specifikuar në piken 11.2 (Shuma e Marrëveshjes Financiare);

"Data e Marrëveshjes Financiare" ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale;

"Çmimi i Marrëveshjes Financiare" ka kuptimin e specifikuar në Kontratën Individuale;

"Detyrimi i Specifikuar" do të thotë çdo detyrim financiar (aktual ose i ardhshëm, i paparashikuar ose ndryshe, si principal ose garanci ose ndryshe) për paratë e marra borxh (që përfshin borxhet e pagueshme të Filialeve si dhe instrumentet e borxheve të institucioneve financiare);

"Vlera Neto e Prekshme" do të thotë shuma e gjithë kontributeve të paguara në cash të aksionarit në llogarinë e përbashkët të kapitalit ose në ndonjë llogari tjetër kapitali të Njesisë Përkatese e vendosur për qëllimet e Njesisë Përkatese dhe çdo fitim i akumuluar pa humbjet e mbajtura të akumuluar dhe asetet e prekshme, përfshirë, por pa u kufizuar me klientelën;

"Taksë" do të thotë çdo taksë e tanishme ose e ardhshme, kuotë, taksë importi, detyrim, pagesë, vlerësim ose tarifë e çdo natyre (përfshirë interesin, gjokat dhe shtesat e tyre) që vendoset nga çdo qeveri ose autoritet tjetër taksash (për përfitimin ose jo të tij) lidhur me çdo pagesë sipas Kontrates përveç taksës së vulës, regjistrimit, dokumentacionit ose ndonjë taksë të ngjashme;

"Kapitalizimi Total" lidhur me periudhën përkatëse do të thotë shuma e Borxhit Total dhe gjithë kontributet e paguara në cash të aksionarit në llogarinë e përbashkët të kapitalit ose ndonjë llogari tjetër kapitali që vendoset për qëllimet e Njesisë Përkatese;

"Borxhi Total" lidhur me periudhën përkatëse, do të thotë shuma e detyrimit financiar për paratë e marra borxh (që përfshin borxhet që u paguhen kompanive filiale si dhe instrumentet e borxhit të institucioneve financiare) të Njesisë Përkatese;

"Periudha Totale e Furnizimit" lidhur me një Kontratë Individuale do të thotë periudha e furnizimit e vendosur mes Palëve;

"TVSH" ka kuptimin e specifikuar në piken 14.1 (TVSH);

"Shkrues" ka kuptimin e specifikuar në piken 5.1 (Livrimi dhe Pranimi Sipas një Opsioni).

Regimi per prodhim k

OSHEE

GRA : DATA

Workarea others

(SHEAL)

[illegible]

PROGRAMI JAVOR I KERKESES SE
KONSUMATOREVE FUNDORE PER ENERGJI
ELEKTRIKE

ORA \ DATA	1	2	3	4	5	6	7	Progresivi I kerkeses per Javen...../2019 (MWh)
Kerkesa Javore (MWh)	-	-	-	-	-	-	-	-
01.00	-	-	-	-	-	-	-	-
02.00	-	-	-	-	-	-	-	-
03.00	-	-	-	-	-	-	-	-
04.00	-	-	-	-	-	-	-	-
05.00	-	-	-	-	-	-	-	-
06.00	-	-	-	-	-	-	-	-
07.00	-	-	-	-	-	-	-	-
08.00	-	-	-	-	-	-	-	-
09.00	-	-	-	-	-	-	-	-
10.00	-	-	-	-	-	-	-	-
11.00	-	-	-	-	-	-	-	-
12.00	-	-	-	-	-	-	-	-
13.00	-	-	-	-	-	-	-	-
14.00	-	-	-	-	-	-	-	-
15.00	-	-	-	-	-	-	-	-
16.00	-	-	-	-	-	-	-	-
17.00	-	-	-	-	-	-	-	-
18.00	-	-	-	-	-	-	-	-
19.00	-	-	-	-	-	-	-	-
20.00	-	-	-	-	-	-	-	-
21.00	-	-	-	-	-	-	-	-
22.00	-	-	-	-	-	-	-	-
23.00	-	-	-	-	-	-	-	-
24.00	-	-	-	-	-	-	-	-

PROGRAMI MUJOR I KERKESES SE KONSUMATOREVE FUNDORE PER ENERGJI ELEKTRIKE
MUJ: 2019

ORA DATA	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	Programi ketones per muje 2019 (BOS)
Perkatese Mujore (BOS)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
01.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
02.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
03.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
04.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
05.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
06.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
07.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
08.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
09.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
10.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
11.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
12.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
13.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
14.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
15.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
16.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
17.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
18.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
19.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
20.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
21.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
22.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
23.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
24.01	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-